


Observeri i Kosovës:

Lufta Diplomatike Ruse
dhe Dezinformimi Medial

15 gusht – 31 tetor, 2021



INFORMATA BAZIKE:

Observeri i Kosovës: Lufta Diplomatike Ruse dhe Dezinformimi Medial – është një raport tremujor që synon t’i analizojë deklaratat publike dhe publikimet të establishmentit të politikës së jashtme të Rusisë, dhe veçoritë e lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformim që kanë për shënjestër Kosovën, të publikuara nga mediat ruse në gjuhën angleze dhe serbe.

PËRKRAHUR NGA::



Londër, Mbretëria e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED).

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1, 10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0)38 542 778

Web-site: www.kipred.org

Email: info@kipred.org

PËRGATITUR NGA:

Lulzim Peci

Përmbledhje Ekzekutive

Observeri i Kosovës: Lufta Diplomatike dhe Dezinformatat Mediale të Rosisë është një raport çerek-vjetror që synon t'i analizojë deklaratat publike, konferencat për shtyp, artikujt dhe dokumentet e tjera, të botuara në ueb-sajtet e Kremlinit, të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Federatës Ruse, të Misionit të Përherëshëm Rus në Kombet e Bashkuara, të Misionit të Përherëshëm Rus në OSBE, të Përfaqësimit të Përherëshëm Rus në Këshillin e Evropës, të Misionit të Përherëshëm Rus në BE, dhe të Ambasadës Ruse në Serbi, e që janë zëdhënësit kyç të luftës diplomatike ruse kundër Kosovës. Për këtë, Observeri i analizon modelet e lajmeve që përmbajnë dezinformata për Kosovën të botuara në mediat e përzgjedhura, domethënë në Rusia Today, Sputnik International, Sputnik Serbia, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, Duran, dhe Pravda Report, të cilat janë dorë e zgjetur e establishmentit të Politikës së Jashtme Ruse në luftën e saj diplomatike kundër Kosovës.

Lidhur me këtë, analiza e deklaratave, konferencave për shtyp, artikujve, dhe dokumenteve të tjera të establishmentit të politikës së jashtme ruse, të lëshuara dhe publikuara nga 15 gushti deri më 31 tetor 2021, tregon se gjatë kësaj periudhe establishmenti i jashtëm i Moskës ka qenë i përqendruar në rrënimin e themeleve të shtetësisë dhe të sovranitetit të Kosovës, duke e krahasuar atë me aneksimin jolegal të Krimesë, në rrënimin e themeleve të angazhimit perëndimor në shtet-ndërtimin e Kosovës dhe në dialogun Prishtinë–Beograd, përmes dënimit të veprimeve të Policisë së Kosovës në pjesën veriore të Kosovës, dhe për zhvillim të “dhunës anti-serbe,” si dhe me reagime të ashpra ndaj shpalljes së dy diplomatëve rusë të akredituar në UNMIK si persona non-grata nga autoritetet kosovare.

Lajmet që kanë përmbajtur dezinformata dhe keqinformime të karakterit malinj për Kosovën, të botuara gjatë kësaj periudhe në mediat ruse të përmendura më sipër, kanë qenë të përqendruara kryesisht në rrënimin e themeleve të legalitetit dhe të shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës, të pasuara nga ato që komunitetin serb dhe Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë i kanë paraqitur si të shtypura dhe të kërcënuara, në rrënimin e themeleve të kredibilitetit të angazhimit Perëndimor në shtetndërtimin e Kosovës dhe në dialogun Prishtinë–Beograd, si dhe në ndryshimin e narrativave të luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi.

Lufta Diplomatike Ruse Kundër Kosovës

Gjatë kësaj periudhe, Ministria e Jashtme Ruse, Misioni i Përhershëm Rus në Kombet e Bashkuara, Misioni Permanent Rus në BE, dhe Ambasada Ruse në Serbi, Kosovën e kanë shënjestruar drejtpërdrejtë, apo në një kontekst më të gjerë, në një mori deklaratash, konferencash për shtyp, dhe deklaratash për shtyp, ndërkohë që Kremlini, Misioni i Përhershëm i Rosisë pranë OSBE-së dhe Misioni i Përhershëm Rus në Këshillin e Evropës, nuk kanë postuar në ueb-sajtet e tyre asnjë publikim që ka patur të bëjë me Kosovën. Në kuadër të këtij sfondi, teksti në vijim do ta paraqesim një analizë kronologjike të përqendruar në temat e këtyre veprimtarive të synuara të luftës diplomatike ruse kundër Kosovës.

Lidhur me këtë, në një intervistë që i ishte dhënë “Euractivit” më 9 shtator 2021,¹ që ishte përqendruar kryesisht në gjendjen në Afganistan dhe në Ukrainë, Përfaqësuesi i Përhershëm i Rosisë në BE, Ambasadori Vladimir Chizhov, u përpoq që aneksimin e paligjshëm të Krimesë ta arsyetonte duke deklaruar se qëndrimi Perëndimor ndaj këtij veprimi agresiv e ka një fuqi legale fare të dobët, dhe duke e vënë atë në dyshim përmes deklaratës në vijim: “Pse Perëndimi do të duhej të konsideronte që një veprim arbitrar i Khrushchevit në vitin 1954, në kundërshtim me të tërë legjislacionin që ekzistonte në atë kohë, do të duhej të ishte një bazë ligjore për atë që është duke ndodhur sot? Ndërkohë që referendumi i cili u bë më 2014 ishte një shprehje e qartë e vullnetit popullor të popullatës së Krimesë,” dhe duke i akuzuar në një mënyrë ironike për njohjen e Kosovës pa ndonjë referendum, meqë pavarësia e Kosovës ishte vënë në dyshim nga pjesa më e madhe e popullatës së saj.

Përballë këtij sfondi, sipas deklaratës për shtyp të lëshuar nga Ministria e Jashtme Ruse,² Ministri i Jashtëm Rus Sergey Lavrov u takua me Ministrin e Jashtëm të Serbisë Seljaković më 25 shtator 2021, në margjinat e sesionit të 76 të Asamblesë së Përgjithshme të KB, në të cilin takim ata e theksuan “qasjen e përgjithshme të përbashkët” ndaj Kosovës dhe Bosnjës e Hercegovinës, duke theksuar në këtë mënyrë koordinimin e tyre ndaj këtyre dy vendeve. Në të njëjtën mënyrë, në një fjalim tejet kritik

¹ Intervista nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Rosisë në BE, Ambasadori Vladimir Chizhov, për “Euractiv,” 9 shtator 2021, [Interview by Permanent Representative of Russia to the EU Ambassador Vladimir Chizhov for "Euractiv", 9 September 2021 - News - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](#), postuar më 13 shtator 2021.

² Njoftim për shtyp për bisedën e Ministrin të Jashtëm Sergey Lavrov me Ministrin e Punëve të Jashtme të Serbisë Nikola Selaković, 25 shtator 2021, [Press release on Foreign Minister Sergey Lavrov's conversation with Minister of Foreign Affairs of Serbia Nikola Selakovic - The UN General Assembly - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](#)

ndaj Perëndimit në këtë sesion të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara,³ ai, ndër të tjera, Perëndimin e akuzon për krijimin e “entitetit artificial të Kosovës” përmes marrjes së dhunshme të saj nga Serbia dhe njohjes së mëpastajme të saj, dhe e justifikon aneksimin e paligjshëm të Krimesë përmes referendumit të panjohur ndërkombëtarisht të vitit 2014, përmes të cilit “populli i Krimesë u përpoq ta bëhej i lirë nga ultra-radikalët që ishin prapa grushtshtetit në Ukrainë të përkrahur nga Perëndimi.”

Këto politika revizioniste ruse të de-facto mosnjohjes së kufijve ndërshtetërorë të ish-republikave të Bashkimit Sovjetik, dhe të vënies në pyetje të legalitetit dhe legjitimitetit të njohjes së Kosovës nga Perëndimi, e paraqesin njëërën ndër arsytet e veprimtarive të saj malinje në Ballkanin Perëndimor. Këto politika synojnë po ashtu që të vejnë në pyetje validitetin e kufijve të Bosnjës e Hercegovinës, duke i përkrahur prirjet separatiste të udhëheqësit të Republikës Serbe, Millorad Dodikut, përmes keqpërdorimit të pavarësisë së Kosovës, në të njëjtën kohë kur ndaj saj e mbajnë një qëndrim armiqësor, dhe duke e krahasuar atë me Krimenë, me qëllim të destabilizimit të Evropës Juglindore dhe të rrënimit të themeleve të përfshirjes afatgjate perëndimore në stabilitetin dhe sigurinë në rajon.

Nga ana tjetër, Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme Ruse, Maria Zakharova, më 24 shtator 2021,⁴ i dënoi autoritetet kosovare për moslejimin e ekipit të gazetarëve të Izvestias, dy nga ta qytetarë rusë, Denis Bolshakov (korrespondent) dhe Oleg Berkach (operator), dhe një qytetari bellorus, Sergei Belous (përkthyes), për të hyrë në territorin e Kosovës, në vendkalimin kufitar të Jarinjës me Serbinë, duke pohuar ndër të tjera që “Ky provokim u bë kundër dy korrespondentëve rusë nga Qendra Informative Multimediale Izvestia (Kanali 5), me përfshirjen e trupave të përkohshme të vetëqeverisjes të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë (KiM), që u sollën si trupa arbitrare me një mungesë të plotë të ligjit.” Ministria e Jashtme Ruse, dhe gazetarët e Izvestias, e dinin fare mirë se për të hyrë në Kosovë qytetarët rusë duhet ta marrin vizën hyrëse që lëshohet nga Ambasada e Kosovës në Tiranë, apo nga Konsulata e Përgjithshme në Stamboll,⁵ dhe që Policia Kufitare e Kosovës ka vepruar në

³ Fjala e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov në Debatën e Përgjithshme të sesionit të 76 të Asamblesë së Përgjithshme. New York, 25 shtator 2021, [Foreign Minister Sergey Lavrov's address at the General Debate of the 76th session of the General Assembly, New York, September 25, 2021 - The UN General Assembly - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](https://www.mfa-ks.net/en/sherbimet_konsullore/503/kush-ka-nevoj-pr-viza-t-kosovs/503)

⁴ Komentet e Zëdhënësës së Ministrisë së Jashtme, Maria Zakharova për informatën për provokimin e Kosovës kundër gazetarëve rusë, 24 shtator 2021, [Foreign Ministry Spokeswoman Maria Zakharova's comment on the Kosovo Albanian information provocation against Russian journalists - Conflicts - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](https://www.mfa-ks.net/en/sherbimet_konsullore/503/kush-ka-nevoj-pr-viza-t-kosovs/503)

⁵ Ministria e Jashtme e Kosovës, https://www.mfa-ks.net/en/sherbimet_konsullore/503/kush-ka-nevoj-pr-viza-t-kosovs/503

pajtim me këtë, mirëpo deklaratat e zëdhënësës janë një përpjekje evidente për t'i goditur themelet pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës, dhe ajo shkon edhe më tej, duke përdorur shprehjen përbuzëse “Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë (KiM),” e cila nuk mund të gjendet madje as edhe në një dokument të vetëm zyrtar të Kombeve të Bashkuara.

Për më tepër, në një “Koment për situatën në Kosovë,” të postuar nga Ministria e Jashtme Ruse më 28 shtator 2021,⁶ Zakharova e akuzon Qeverinë e Kosovës për përshkallëzimin e tendosjeve në veri të vendit, duke pohuar që “Civilët, në mesin e të cilëve ka viktima, i janë nënshtruar dhunës. Disa njerëz u hospitalizuan.” Mirëpo, realiteti ishte në tërësi i ndryshëm, meqë gjatë krizës në pjesën veriore të Kosovës Policia e Kosovës nuk e ka shfrytëzuar fare forcën gjatë “mbrojtjes parandaluese” të vendkalimeve kufitare me Serbinë Jarinje dhe Bërnjak, dhe që kjo u zgjidh me marrëveshjen midis dy vendeve për tabelat e regjistrimit, që u ndihmua nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, e që u arrit në Bruksel më 30 shtator 2021.⁷ Më tutje, më 30 shtator 2021, në konferencën për gazetarë, Zëvendës Drejtori i Departamentit të Informimit dhe Shtypit të Ministrisë së Jashtme Ruse, Alexey Zaytsev, i akuzoi autoritetet e Kosovës për krizën në veriun e vendit, dhe i mohoi akuzat e Presidentes së Kosovës, Osmani, që “autoritetet e Beogradit, të ndikuara nga Rusia, janë duke nxitur tendosje në Kosovën veriore dhe duke u përpjekur për ta destabilizuar rajonin.”⁸

Megjithatë, kjo deklaratë nuk e pasqyron mungesën e përfshirjes malinje ruse në këtë krizë. Më 26 shtator 2021, Ambasadori Rus në Beograd, Alexander Botsan-Kharchenko, në shoqërim të Ministrit Serb të Mbrojtjes, Stefanović, i inspektoi forcat ushtarake serbe afër kufirit me Kosovën, e të cilat ishin në një gjendje të gatishmërisë së lartë luftarake. Në një mënyrë paradoksale, ai nga këtu i përkrahu “përpjekjet e Beogradit për ta qetësuar situatën tejet të rrezikshme,” dhe i akuzoi BE-në dhe SHBA-të për “zbatimin e standardeve të dyfishta dhe për mbylljen e syve para një situatë që ata nuk donin ta kuptonin, përfshirë atë se kush është për t'u fajësuar për atë se çfarë po ndodhte.”⁹

⁶ Koment nga përfaqësuesja zyrtare e Ministrisë së Jashtme Ruse, Maria Zakharova, për situatën në Kosovë, 28 shtator 2021, [Comment by Russian Foreign Ministry spokeswoman Maria Zakharova on the situation in Kosovo - News - Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](https://www.mid.ru/en/web/guest/foreign_policy/news/-/asset_publisher/cKNonkJE02Bw/content/id/4875750)

⁷ Serbia, Kosovo Reach Compromise To End Border Deadlock [Serbia, Kosova, Arrijnë Kompromis për ta Përfunduar Bllokimin rreth Kufirit], Radio Free Europe, 30 shtator 2021, <https://www.rferl.org/a/kosovo-serbia-border-agreement/31485862.html>

⁸ Informim për gazetarë, Zëvendës Drejtori i Departamentit për Informim dhe Shtyp i Ministrisë së Jashtme Ruse, Alexey Zaytsev., 30 shtator, 2021, https://www.mid.ru/en/web/guest/foreign_policy/news/-/asset_publisher/cKNonkJE02Bw/content/id/4875750

⁹ Euractiv.rs, Northern Kosovo situation sparks international response [Gjendja në Kosovën Veriore nxit reagim ndërkombëtar], 27 shtator 2021, https://www.euractiv.com/section/politics/short_news/northern-kosovo-situation-sparks-international-response/

Për më tutje, një konferencë të përbashkët për shtyp, pas takimit me Presidentin e Serbisë Vučić më 10 tetor 2021,¹⁰ Ministri i Jashtëm rus Lavrov, ndër të tjera, ripohoi qëndrimin e Presidentit Putin që, si rezultat i dialogut me Kosovën, Rusia do ta pranojë çdo vendim që i përshtatet Serbisë dhe popullit serb, dhe që kjo ‘çështje’ duhet të bazohet vetëm në Rezolutën 1244 të KS KB, dhe që vendimi përfundimtar duhet t’i jipet KS KB për miratim. Në mënyrë ironike, ai shtoi se Rusia supozon që SHBA-të do ta shfrytëzojnë ndikimin e vet të konsiderueshëm në Kosovë për të “ardhur deri te marrëveshjet që do të jenë në harmoni me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe që do t’i përshtaten miqve tanë serbë,” dhe ai e kritikoi BE-në që nuk është në gjendje ta bindë Kosovën për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Kjo deklaratë e Lavrovit, në thelb e tregon synimin e Kremlinit për të luajtur me letrën e vetos së dyfishtë, me qëllim që ta bllokojë arritjen e çfarëdo qoftë marrëveshjeje për normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, së pari, duke u përpjekur që Beogradit t’ia ofrojë një “veto virtuale” në dialog, duke kërkuar që rezultati duhet t’i përshtatet vetëm interesit të Serbisë, me qëllim që atë ta mbajë si një bazë të qëndrueshme të ndikimit të vet në rajon, nga njëra anë, dhe duke kërcënuar në mënyrë të nënkuptuar për të vënë veto në Këshillin e Sigurisë të KB për çfarëdo marrëveshjeje që nuk i përshtatet interesave ruse, domethënë, për ta bllokuar anëtarësimin e mundshëm të Kosovës në KB, dhe për ta mbajtur të hapur deri në pakufi konfliktin midis Kosovës dhe Serbisë, nga tjetra. Pjesa më ironike e kësaj deklaratë është “supozimi” rus që SHBA-të do ta çojnë përpara ndonjë marrëveshjeje që do t’i përshtatet vetëm interesit të Serbisë, duke nënkuptuar këtu edhe injorimin e Opinionin Këshillues të GJND të korrikut 2010, i cili, ndër të tjera, pohonte që Shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur Rezolutën 1244 të KS KB.

Në anën tjetër, Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme Ruse, Zakharova, në një komentim të deklaratës së 10 tetorit 2021, të Kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama, për “bashkimin e Kosovës me Shqipërinë,” e akuzoi Perëndimin si përgjegjës për pavarësinë e Kosovës, dhe për atë që ishte i qetë ndaj kësaj deklaratë të Ramës, ndërkohë që “e sulmon Beogradin për konceptin e vet të arsyeshëm humanitar për Botën Serbe, i cili nuk shkon në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.”¹¹ Kjo deklaratë e

¹⁰ Vërejtjet dhe përgjigjet e Ministrit të Jashtëm Lavrov në pyetjet e meidave në konferencën e përbashkët për shtyp pas bisedimeve me Presidentin e Republikës Serbe Aleksandar Vučić, Beograd, 10 tetor 2021, [Foreign Minister Sergey Lavrov's remarks and answers to media questions at a joint news conference following talks with President of the Republic of Serbia Aleksandar Vucic, Belgrade, October 10, 2021 - Conflicts - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](#)

¹¹ Koment i Zëdhënësës së Ministrisë së Jashtme Ruse, Zakharova, në deklaratën e Kryeministrit Edi Rama, 10 tetor, 2021 [Comment by Foreign Ministry Spokeswoman Maria Zakharova on the statement by Prime Minister of Albania Edi Rama - Conflicts - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](#)

Zakharovës u vijua nga deklarata e Ministrit të Brendshëm të Serbisë, Aleksandar Vulin, i cili “e shpjegoi” “konceptin humanitar” të “Botës Serbe” duke deklaruar se e vetmja pengesë ndaj “Shqipërisë së Madhe,” dhe e vetmja forcë që do të mundësojë që serbët të mos marrin ndonjë vendim të ndikuar nga të tjerët, është uniteti politik serb dhe krijimi i “Botës Serbe.”¹²

Në një komentim tjetër të Ministrisë Ruse të Punëve të Jashtme, atë të 14 tetorit 2021,¹³ Zëdhënësja Zakharova, si një reagim ndaj operacionit mbarë-kosovar kundër kontrabandës dhe krimit të organizuar, që u ndërморr më 13 tetor 2021, akuzoi autoritetet kosovare për sulmin ndaj “zonave të populluara me serbë në Veri të Kosovës” duke e emërtuar këtë si “ripërtëritje të dhunës anti-serbe” në Kosovë. Për më tepër, ajo kërkoi nga KFOR-i që ta zbatonte mandatin e vet sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurisë së KB dhe “t’i ndalë radikalët e tërbuar shqiptarë të Kosovës,” duke shfrytëzuar shprehje që nuk i përshtaten një diplomati. Ky reagim e shpreh qëllimin e Ruisë për ta mbajtur veriun e Kosovës si një zonë ku nuk sundon ligji dhe që është jashta qasjes dhe kontrollit të Prishtinës, si një vend ku ajo mund ta ushtrojë ndikimin e vet ndër radikalët lokalë serbë, dhe që në këtë mënyrë ta mbajë situatën e tensionuar duke e ruajtur imazhin e një “konflikti të ngrirë,” me qëllim që më pas ta rrëmihë sovranitetin e Kosovës në këtë pjesë të vendit.

Në të njëjtën frymë ishte edhe deklarata e Përfaqësuesit të Përhershëm Vassily Nebenzia në seancën informuese të 15 tetorit 2021 të KS KB për situatën në Kosovë, në të cilën ai fillimisht e ofendoi Presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, duke pohuar që fjala e saj ishte një pamflet propagandues dhe një përrallë. Ndër të tjera, ai situatën e serbëve në Kosovë e paraqiti si një që është duke u përkeqësuar, dhe e dënoi zhvillimin e aftësive ushtarake të Forcës së Sigurisë së Kosovës, e akuzoi qeverinë e Kosovës për moszbatimin e marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, dhe insistoi që vetëm UNMIK-u e ka të drejtën për ta përfaqësuar “krahinën.”

Mirëpo, reagimet e Ruisë u bënë edhe më të vrazhda më 22 tetor 2021, kur Ministria e Jashtme e Kosovës i shpalli si persona non-grata dy diplomatë rusë të Zyres së Ambasadës Ruse në Prishtinë, të akredituar në UNMIK, Denis Vengerski dhe Alexey Kryvosheev, për shkak të “rrenimit të sigurisë kombëtare dhe të rendit kushtetues” të Kosovës. Në reagimin e përnjëherëshëm që e vijoi këtë

¹² B92, Serbia's response to “unification of Albania and Kosovo,” [Reagimi i Serbisë ndaj “bashkimit të Shqipërisë me Kosovën,”] 10 tetor 2021,

https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2021&mm=10&dd=10&nav_id=111942

¹³ Koment i Zëdhënësës së Ministrisë së Jashtme Ruse, Zakharova, ndaj përsëritjes së dhunës anti-serbe në Kosovë, 14 tetor 2021, [Comment by Foreign Ministry Spokeswoman Maria Zakharova on the recurrence of anti-Serb violence in Kosovo - Conflicts - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](#)

vendim, Shërbimi i Shtypit i Ambasadës Ruse në Beograd pohoi, “Ne nuk e njohim ‘pavarësinë’ e Kosovës, dhe, kësisoj, ‘qeverinë e krahinës’ dhe ‘struktura’ të tjera. Për ne, kurrfarë ‘vendimesh’ të Prishtinës nuk kanë forcë ligjore,” dhe “bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë së KB, ne jemi duke bashkëpunuar me UNMIK-un lidhur me këtë çështje,” duke shtuar, po ashtu, që kjo është “një përpjekje në tërësi e papranueshme për t’i penguar diplomatët e akredituar nga UNMIK-u në kryerjen e veprimtarive të tyre në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.”¹⁴ Pos kësaj, në komentën e 23 tetorit 2021, Zëdhënësjë e Ministrisë së Jashtme Zakharova këtë vendim të autoriteteve kosovare e quajti si një “provokim të madh anti-rus.” Për më tepër, ajo pohoi se “sipas të gjithë treguesve,” ky është “një provokim i qëllimtë me qëllim që t’i shërbejë projektit Perëndimor të krijimit të një entiteti shtetëror shqiptar marionetë që do ta ndjekë një politikë agresive, të orientuar kundër Rusisë dhe rolit të saj konstruktiv në Ballkan.”¹⁵ Më tutje, në një konferencë për shtyp të 28 tetorit 2021,¹⁶ ajo nuk mundi ta mohonte ekzistencën e notës verbale të Zyres së Ambasadës së Federatës Ruse në Prishtinë, të drejtuar Ministrisë së Jashtme të Kosovës të 27 nëntorit 2020, të cilën ish Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës, Meliza Haradinaj, e postoi në faqen e saj të Twitterit.¹⁷ Në vend të kësaj, Zakharova konsideron që bërja publike e kësaj note verbale synon ta bindë publikun kosovar që qëndrimi i Rusisë ndaj Kosovës dhe Rezolutës 1244 të KS KB është “duke ndryshuar dhe duke u lëkundur.”

Sidoqoftë, sipas Policisë së Kosovës, diplomatët rusë të shpallur non-grata e braktisën territorin e Kosovës në vendkalimin kufitar me Serbinë në Merdare, në pasditen e 23 tetorit, 2021.

¹⁴ Sputnik Serbia, Rusija odgovorila Prištini: Ne priznajemo ni tzv. Kosovo ni odluke “vlade,” [Rusia iu përgjegi Prishtinës: Nuk e pranojmë as të ashtuquajturën Kosovë, as vendimin e “qeverisë,”] 22 tetor 2021, [Rusija odgovorila Prištini: Ne priznajemo ni tzv. Kosovo ni odluke „vlade“ \(sputniknews.com\)](https://www.sputniknews.com/en/news/2021/10/22/russia-answers-priştina-1244-resolution/)

¹⁵ Koment nga përfaqësuesja zyrtare e Ministrisë së Jashtme Ruse, Maria Zakharova, lidhur me provokimin anti-rus të Prishtinës, 23 tetor 2021, [Comment by Russian Foreign Ministry spokeswoman Maria Zakharova on Pristina’s anti-Russian provocation - News - Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/-/newsById/1987703)


¹⁶ Informim nga Zëdhënësjë e Ministrisë së Jashtme Maria Zakharova, Moskë, 28 tetor 2021, [Briefing by Foreign Ministry Spokeswoman Maria Zakharova, Moscow, October 28, 2021 - News - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/-/newsById/1987703)

¹⁷ https://kallxo.com/wp-content/uploads/2021/10/FCVL_5cXMAgepHk.jpg


Dezinformimi i Mediave Ruse për Kosovën

Botimet e përzgjedhura mediale me origjinë në Rusi që u monitoruan nga 15 gushti deri në 31 tetor 2021 janë Russia Today, Sputnik International, Sputnik Serbia, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, the Duran dhe Pravda Report.


Monitorimi i të dhënave tregon se gjatë kësaj periudhe mediat e sipërpërmendura kanë botuar 598 lajme që kanë qenë të ndërlidhura drejtpërdrejtë apo tërthorazi me Kosovën. Sputnik – Botimi në Serbisht i ka botuar 519, Russia Today 25, TASS-i 22, Sputnik International 15, Russia Insider 7, Newsfronti 6, Pravda Reporti 2, Durani 2, dhe Meduza, Moscow Times dhe UNZ-i asnjë.



Një vështrim i përgjithshëm i lajmeve të botuara nga këto media, që u ndërmorr nga KIPRED-i, tregon se nga 598 lajmet e ndërlidhura drejtpërdrejt me Kosovën, 116 prej tyre (apo 19,4%) kanë përmbajtur dezinformata.




Numri më i madh i dezinformatave u botua nga Sputnik Serbia (77), pasuar nga TASS-i (12), Russia Today (8), Russian Insider (6), Sputnik International (5), UNZ (4), Newsfront (4), The Duran (2) dhe Pravda Report (2).




Me qëllim që ta kemi një pamje më të mirë të modeleve dezinformuese që e shënjestrojnë Kosovën, në lajmet e botuara nga mediat e sipërpërmendura ruse, përqendrimi kryesor i përmbajtjes së tyre ka qenë i grumbuluar rreth synimeve vijuese dezinformuese:

- Rrënimi i themeleve të legalitetit dhe të shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës.
- Ndryshimi i narrativave të luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi.
- Rrënimi i kredibilitetit të angazhimit Perëndimor në shtetndërtimin e Kosovës dhe në dialogun Prishtinë–Beograd.
- Paraqitja e komunitetit serb dhe e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si të shtypura dhe të kërcënuara.

Lidhur me përmbajtjen e lajmeve që kanë pasur dezinformime të botuara në këto media ruse, numri më i madh i tyre ka synuar t'ia rrënojë themelet e legalitetit të shtetësisë dhe të sovranitetit të Kosovës (48), vijuar nga paraqitja e komunitetit serb dhe e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si të shtypura dhe të kërcënuara (32), rrënimi i themeleve të kredibilitetit të angazhimit Perëndimor në shtetndërtimin e Kosovës dhe në dialogun Prishtinë–Beograd (28), dhe ndryshimi i narrativave të luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi (8).



Analiza e modeleve të lajmeve të grumbulluara me dezinformata që janë botuar nga mediat ruse të përmendura më sipër tregojnë se ato janë kryesisht të përqendruara në rrënimin e themeleve të legalitetit dhe të shtetësisë e sovranitetit të Kosovës, dhe në dezinformatat që synojnë paraqitjen e komunitetit serb dhe të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si të shtypura dhe të kërcënuara, si dhe në rrënimin e themeleve të kredibilitetit të angazhimit perëndimor në shtetndërtimin e Kosovës dhe në dialogun Prishtinë–Beograd. Është interesante që lajmet me dezinformata që e synojnë ndryshimin e narrativave të luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi kanë patur shumë më pak vëmendje në këto media sesa në raportin paraprak.



Përfundim

Një moment i rëndësishëm për intensifikimin e bashkëpunimit ruso-serb kundër shtetësisë së Kosovës dhe stabilitetit dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor mund të ketë ndodhur gjatë vizitës së Presidentit serb në Moskë dhe takimit të tij me Presidentin rus Putin më 25 nëntor 2021. Lidhur me këtë, duhet të vërehet se përplasjet e fundit midis Prishtinës dhe Beogradit, si dhe ato midis Prishtinës dhe Moskës, të shoqëruara me mungesën e progresit në dialogun e ndihmuar nga Brukseli midis Kosovës dhe Serbisë, e kanë krijuar një tokë të pllëshme për intensifikimin e mëturshëm të luftës diplomatike të Rosisë kundër Kosovës dhe për rrënimin e themeleve të përpjekjeve të Perëndimit për gjetje të një zgjidhjeje të qëndrueshme të mosmarrëveshjeve midis dy vendeve fqinje.

Ashtu siç u përmend edhe në analizat e mësipërme, politikat revizioniste ruse të de facto mosnjohjes së kufijve ndërshtetërorë të ish-republikave sovjetike dhe të vënies në pyetje të legalitetit dhe të legjitimitetit të njohjes së Kosovës nga Perëndimi, janë një nga arsytet e veprimeve të tyre malinje në Ballkanin Perëndimor. Këto politika revizioniste të Kremlinit synojnë po ashtu që ta vejnë në pyetje edhe validitetin e kufijve ndërshtetërorë të Bosnjës e Hercegovinës, duke i përkrahur prirjet separatiste të udhëheqësit të Republikës Serbe Millorad Dodikut, dhe duke e keqpërdorur dhe mbajtur qëndrimin armiqësor ndaj pavarësisë së Kosovës, duke e krahasuar atë edhe me Krimenë, me qëllim të destabilizimit të Evropës Juglindore dhe rrënimit afatgjatë të themeleve të përfshirjes së Perëndimit në stabilitetin dhe në sigurinë e rajonit.

Lidhur me këtë, analizat e deklaratave, të konferencave për shtyp, të arikujve dhe të dokumenteve të tjera të establishmentit të politikës së jashtme ruse nga 15 gushti deri më 31 tetor 2021, tregojnë qartë vazhdimin e synimit të narrativave për t'i rrënuar themelet e shtetësisë së Kosovës dhe të angazhimit perëndimor në Kosovë dhe në rajon, si dhe për t'i akuzuar autoritetet kosovare për ushtrim të dhunës ndaj komunitetit serb, dhe për t'ua mohuar atyre të drejtën e tyre për të luftuar kundër kriminit të organizuar në të tërë territorin e vendit. Aktivitetet publike të establishmentit të politikës së jashtme ruse kundër Kosovës gjatë kësaj periudhe janë intensifikuar që nga gjysma e dytë e shtatorit 2021 me fillimin e krizës afatshkurtër në pjesën veriore të Kosovës dhe me dëbimin e dy diplomatëve rusë të Zyres së Ambasadës së Rosisë në Prishtinë, në fundin e tetorit 2021.

Së fundi, analizat e diskurseve të lajmeve (116) që kanë përmbajtur dezinformata dhe keqinformime malinje nga mediat e përzgjedhura, të cilat janë dorë e zgjatur e Moskës, tregojnë se, në përgjithësi, ato

e ndjekin narrativat e establishmentit të politikës së jashtme të Putinit, ndërkokë që Sputnik Serbia, Russia Today dhe TASS-i janë në ballë të këtyre veprimtarive informative malinje kundër Kosovës.